

## Specifikime teknike për Ushqime Koloniale

### Specifikime teknike për artikullin

#### “SHEQER”

Bazuar në STAZH.....1413/87

#### **Lloji: Sheqer**

**1. Pamja e jashtme:** Pluhur i përberë nga kristale të imta dhe të njëllajta. Pa copa sheqeri të ngjeshura ose lëndë të huaja. Të jetë i derdhur i thatë në të prekur dhe të mos ngjitet .

**Ngjyra:** E bardhë dhe me shkëlqim.

**Era dhe shija:** Shije të ëmbël. Pa shije dhe erë të huaj dhe kur është kristal edhe kur tretet në ujë të pastër.

**Tretshmeria:** Tretet plotesisht në ujë. Tretësira është e tejdukshme dhe pa ngjyrë.

#### **Treguesit fiziko kimikë:**

1. Lagështira në % jo më shumë se ...0.16 (për efekte ruajtje)
2. Sheqer i paster i llogaritur ne lende absolutisht të thate ne % jo me pak se 99.6.
3. Lëndë reduktuese (sheqer invert) ne % jo me shumë se 0.1.
4. Hiri në % jo më shumë se 0.07.
5. Përzierje hekuri me madhësi deri ne 0.3 mm,mg/1kg jo me shume se 3.
6. Ngjyra sipas njesive shtamore (llogaritur ne lende absolutisht të thate)ne % jo me shume se 1.

#### **Markërimi:**

- Emërtimi i prodhuesit.
- Emri i produktit.
- Pesha neto ose vëllimi i produktit.
- Data e prodhimit.
- Data e skadimit (Data e jetëgjatësisë minimale).
- Kushtet e veçanta të ruajtjes.
- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë. Këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

**Ambalazhimi:** Të bëhet në thasë të pastër, të thatë polietileni, të qepur në grykë me masë 25-50 kg. Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet ne menyre që të mos shpëputet nga ambalazhi.

- Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jene të qarta, të dukshme mire, të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme ne kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

- N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jete lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.
- Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.
- N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret nje etikete shtese që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.
- Në rastin kur etiketa është zëvendësuar , apo plotësuar me nje tjetër shenimet e detyrueshme duhet të jene pikë për pikë si të etiketës orgjinale.
- Malli të shoqërohet me certifikatë orgjine dhe raportë analize të laboratorit.

### Specifikime teknike për artikullin

#### “FASULE”

Bazuar në STAZH.....1723/87

#### Lloji: Fasule të thata të bardha

**Pamja e jashtme:** Kokrra të shëndosha, të pastra në formë dhe madhësi sipas llojit.

**Ngjyra:** E bardhë

**Era dhe shija:** Karakteristikë e fasules së bardhë, të hidhur, pa erë myku dhe erë tjetër të huaj. Pas zierjes ka ere të këndshme.

#### Treguesit fiziko kimikë:

- 1.Lagështira në % jo më shumë .....15(për efekte ruajtje)
- 2.Lëndë të huaja jo me shume se.....0.8
- 3.Kokrra të thyera në % jo me shumë se.....13
- 5.Kokrra të verdha të pazhvilluara normalisht e të rruhdura në % jo më shumë se .....1
- 6-Perzierje kokrrash ne % jo me shume se..... 2.2
- 7-Lëndë minerale..... nuk lejohen
- 8-Dëmtues hambari,demtimet nga insektet.....nuk lejohen

**Ambalazhimi:** Të bëhet në thasë të pastër, të thatë polietileni, të qepur në grykë me masë 25-50 kg.

#### Markerimi:

Emërtimi i prodhuesit

Emri i produktit

Pesha neto ose vëllimi i produktit

Data e prodhimit

Data e skadimit (Data e jetëgjatësisë minimale)

Kushtet e veçanta të ruajtjes

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

**Ambalazhimi:** Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në menyre që të mos shkëputet nga ambalazhi.

Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jene të qarta, të dukshme mire, të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme ne kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jete lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.

Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.

N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret nje etiketë shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.

Në rastin kur etiketa është zëvendësuar , apo plotësuar me nje tjetër shenimet e detyrueshme duhet të jene pikë për pikë si të etiketës orgjinale.

Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raportë analize të laboratorit.

## Specifikime teknike për artikullin

### “MAKARONA”

Bazuar ne STAZH.....1170/87

#### Lloji: Makaronë e thjeshtë Spageti

**Ngjyra:** E bardhë me nuancë të verdhe. Ne thyerje paraqiten qelqore në jo me pak se gjysmën e siperfaqes së seksionit.

**Era dhe shija: E mire,** karakteristike e makaronave, pa shije të hidhur të thartë të mykur dhe pa erë tjetër të huaj.

Pas zierjes ka erë të këndshme.

#### Treguesit fiziko kimikë:

1. Lagështira në % jo më shumë .....13(për efekte ruajtje).
2. Aciditeti ne %,acid sulfuric jo më shumë se .....0.16.
3. Rritja e vëllimit pas zierjes jo më pak se..... dy here.
4. Insekte dhe dëmtues të tjerë .....nuk lejohen.

**Ambalazhimi:** Të bëhet në leter ambalazhi të paster ose polietileni me masë 1kg.

Në çdo pako shmangia e lejueshme.....  $\pm 2\%$ .

#### Markërimi:

- Emërtimi i prodhuesit
- Emri i produktit
- Pesha neto ose vëllimi i produktit
- Data e prodhimit
- Data e skadimit (Data e jetëgjatësisë minimale)
- Kushtet e veçanta të ruajtjes

- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë. Këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

**Ambalazhimi:** Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.

- Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mirë, të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.
- N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.
- Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.
- N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret një etikete shtese që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.
- Në rastin kur etiketa është zëvendësuar, apo plotësuar me një tjetër shënime të detyrueshme duhet të jenë pikë për pikë si të etiketës origjinale.
- Malli të shoqërohet me çertifikatë orgjine dhe raportë analize të laboratorit.

### Specifikime teknike për artikullin

#### “ORIZ”

Bazuar në STAZH.....	1738-87
ZV .....	1451-85, 1738-84
Grupi .....	K-12
KDU .....	664-71 “oriz”

#### Lloji: Oriz i zhveshur cilësia e parë.

1. **Pamja e jashtme:** Kokrra të shëndosha, të pastra .të zhveshura tërësisht nga lëvozhga e orizit, pa shënja myku ose prishje.
2. **Ngjyra:** E bardhë.
3. **Era dhe shija :**Karakteristike e orizit të shëndoshë, pa shije të thartë, të hidhur, pa erë myku dhe erë tjetër të huaj.
- 4.

#### Treguesit fiziko kimikë:

1. Lagështira në % jo më shumë se .....15(për efekte ruajtje)
2. Lëndë të huaja (mel,farna të barnave të këqija, byk kashte, kokra boshe,etj % jo më shumë se 0.2
3. Kokrra jeshile të pazhvilluara në % jo më shumë se .....0.3
4. Kokrra të thyera më të vogla se gjysma në % jo më shumë se..... 12
5. Kokrra të kuqe në % jo më shumë se ..... 5
6. Kokrra të verdha në % jo më shumë se ..... ..2

7. Kokrra miellore në % ..... nuk lejohen  
 8. Lëndë minerale në % ..... nuk lejohen  
 9. Dëmtues hambari.....nuk lejohen  
 10.Kokrra të prishura nga vetëngrohja, të mbira të prishura të nxira.....nuk lejohen  
 11.Kokrra të zhveshura.....nuk lejohen

**Ambalazhimi:** Të bëhet në thasë të pastër, të thatë polietileni, të qepur në grykë me masë 25-50 kg.

**Markërimi:**

- Emërtimi i prodhuesit
- Emri i produktit
- Pështa neto ose vëllimi i produktit
- Data e prodhimit
- Data e skadencës (Data e jetëgjatësisë minimale)
- Kushtet e vecanta të ruajtjes
- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë.këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

**Ambalazhimi:** Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në mënyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.

- Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jënë të qarta ,të dukshme mire ,të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.
- N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jete lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.
- Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.
- N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret një etikete shtese që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.
- Në rastin kur etiketa është zëvendësuar , apo plotësuar me një tjetër shenimet e detyrueshme duhet të jënë pikë për pikë si të etiketës orgjinale.
- Malli të shoqërohet me certifikatë orgjine dhe raportë analize të laboratorit.

**Specifikime teknike për artikullin**

**“VAJ ULLIRI ;STAZH 102-87”**

**Treguesit organo leptike:** Pamja e jashtme të jetë e kthjellët dhe pa asnjë turbullire .

- Ngjyra të jetë e verdhë deri në lehtësisht jeshile. –
- Era dhe shija karakteristike të vajit të ullirit.
- Nuk duhet të përmbajë lëndë të huaja, të jetë i rafinuar,aciditeti nuk duhet të kalojë 0.5 %.

**Ambalazhimi** në shishe 0.5-1 litërshe qelqi ose plastike transparente me etiketë ku të shënohen standardet.

Nuk duhet të jetë i perzier me vajra të tjerë dhe konservantë.  
 Treguesit e tjerë fiziko kimik sipas STAZH.

Markërimi:

Emërtimi i prodhuesit.

- Emri i produktit .
- Pësja neto ose vëllimi i produktit.
- Data e prodhimit .
- Data e skadimit.

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë, këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

**Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raportë analize të laboratorit**

### Specifikime teknike për artikullin

#### “VAJ LULEDIELLI I RAFINUAR”

Bazuar në STAZH.....203 2003

1. **Pamja e jashtme:** Në gradë Celsius...lëng vajor i qartë pa depozitime.
2. **Ngjyra:** E verdhë e lehtë’
3. **Era dhe shija:** Karakteristikë e vajit të lulediellit, e mirë, pa shije dhe pa erë të huaj.

#### Treguesit fiziko kimikë

1. Aciditeti i shprehur ne acid oleic jo më shumë se.....0.2 g\100g vaj
2. Masa specifike në 20 gradë Celsius .....0,918-0,923
3. Lageshtira dhe lëndët fluturuese në 105 °C %, jo më shumë se..... 0,2
4. Numri i sapunifikimit në mg KOH\g vaj.....188-194
5. Numri i jodit sipas Hanusit .....118-141
6. Lëndët e ptretshme në eter ose benzol, në %, jo më shumë se.....0.05
7. Përmbajtja e sapunve në %, jo me shumë se .....0.005
8. Lëndët e pasapunifikueshme në jo më shumë se .....15g\kg
9. Numri i peroksideve jo me shume se .....10 mek O<sub>2</sub> aktiv\kg vaj
10. Treguesit e refraksionit.....1,461-1,468
11. Përmbajtja e mikroelementve, mg\kg vaj jo më shumë se:
  - Hekur .....1,5
  - Bakër.....0,1
  - Plumb .....0,1
  - Arsenik .....0,1

Treguesit e mësipërm janë të detyrueshëm.

**Ambalazhi:** me kuti metalike të llakuara nga brenda me material të përshtatshëm për produkt, ushqimor ose shishe plastike (PET) me mase 1-5 litra me tapa metalike ose plastike me shirit PVC me stampën perkatëse.

Shishet ambalazhohen në kuti kartoni të mbyllura mire ose me material tjetër të përshtatshëm .

Shmangia në vëllim është deri  $\pm 1\%$ .

Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa.

**Ambalazhimi:** Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në menyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.

- Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mire, të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.
- N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.
- Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.
- N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret një etiketë shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.
- Në rastin kur etiketa është zëvendësuar, apo plotësuar me një tjetër shënime të detyrueshme duhet të jenë pikë për pikë si të etiketës origjinale.

**Markerimi:** Në etiketë të përcaktohet emërtimi i produktit ushqimor vaj luledielli i rafinuar, emri i prodhuesit, lëndën e parë që përdoret për prodhimin e produktit ushqimor, kushtet e veçanta të ruajtjes, rekomandime.

Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raportë analize të laboratorit

Në ambalazhim plastik ose metalik të vendoset data e prodhimit.

Data e skadencës (Data e jetëgjatësisë minimale)

**Çdo parti malli të shoqërohet me certifikatat origjine dhe raportë analize të laboratorit**

### **Specifikime teknike për artikullin**

#### **“KRIPE E JODIZUAR”**

Bazuar në STAZH.....1437/01.07.1995

**Lloji: Kripë ushqimore përpunuar dhe bluar për përdorim në kuzhinë.**

**Pamja:** Masë kokrrizore

**Ngjyra:** E bardhë

**Era dhe shija :** E kripur pa shije dhe erë të huaj.

**Treguesit fiziko kimikë:**

1. Imtësia në mm .....0.2 – 2
2. Klorur Në lëndën e thatë ne % .....jo me pak se 98
3. Klorur Mg në lëndën e thatë ne % .....jo me shumë se 0.3
4. Sulfat Mg në lëndën e thatë ne % .....jo me shumë se 0.9
5. Sulfat Ca në lëndën e thatë ne % .....jo me shumë se 0.2
6. Lëndë të patretshme në lëndën e thatë në % .....jo me shumë se 0.3
7. Lageshtirë në % .....jo me shumë se 1
8. Jodur kaliumi mg\kg ..... 50 + - 3

Kripa të plotësojë të gjithë kërkesat higjieno shëndetsore dhe normat e miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

**Ambalazhimi:** Të bëhet në qese të paster ose polietileni ushqimore, opak me masë 1 – 25 kg.

**Markërimi:**

- Emërtimi i prodhuesit
- Emri i produktit
- Pesha neto ose vëllimi i produktit
- Data e prodhimit
- Data e skadimit (Data e jetëgjatësisë minimale)
- Kushtet e veçanta të ruajtjes
- Rekomandime për përdorim, nëse këto ndikojnë në mënyrë të ndjeshme mbi afatet e ruajtjes së cilësisë ose mbi vlerat e produktit ushqimorë.këto të dhëna të jepen mbi ambalazh ose mbi etiketë.

**Ambalazhimi:** Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në menyre që të mos shkëputet nga ambalazhi.

- Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta ,të dukshme mirë ,të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme ne kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.
- N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jete lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.
- Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.
- N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret nje etiketë shtesë që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.
- Në rastin kur etiketa është zëvendësuar , apo plotësuar me një tjetër shënimet e detyrueshme duhet të jenë pikë për pikë si të etiketës orgjinale.
- Malli të shoqërohet me certifikatë orgjine dhe raportë analizë të laboratorit.



## Specifikime teknike për artikullin

### “MIELL GRURI”

**Bazuar në STASH** .....1455\87

**Lloji:** Miell gruri me rreze 80 %

**Treguesit shqisor:**

**Ngjyra:** E bardhë me nuancë të lehtë në të verdhë në varësi të llojit të grurit.

Pjesezat e himeve janë të padukshme me rreze 80 %.

**Era dhe shija:** Karakteristikë e miellit të grurit, pa erë myku, pa shije të hidhur e të thartë dhe pa erë e shije të huaj. Nuk lejohen kërcitje.

**TREGUESIT FIZIKE DHE KIMIKE**

**Lageshtira** ,%, jo më shumë se..... 14

**Aciditeti** i shprehur në acid sulfurik në lëndët absolutisht të thata %, jo më shumë se.. . 0.115

**Hiri i tretshëm**, në lëndën absolutisht të thate %, ..... jo më shumë se 0.9

**Hiri i patretshëm** në acid klorhidrik 10%; në lëndën absolutisht të thate, %,

.....jo më shumë se 0.1

**Mbisitja** (imtësia e bluarjes ):Për miellrat e bluar në fabrikat me cilindra:

Në sitën metalike nr.54, %, ..... jo më shumë se 2

Në sitën e mëndafshit 5 xxx, %, .....jo më shumë se 5

**Gluteni** i njomë ,%, jo më pak se..... 25

**Lënde minerale** .....nuk lejohen

**Perzierje metalike.**Plumbi, zinku e bakri..... nuk lejohen

Lejohet permbajtja e hekurit në formë thërmijash nën 0.3 mm, .....jo më shumë se 3mg.g

**Mikroorganizma** patogjene, infestime dhe demtues hambari të gjallë, ..... nuk lejohen

**Ambalazhimi dhe transportimi.**

Ambalazhimi bëhet në thasëpolietileni të paster të qepur në grykë me masë 25-50kg.

Mbi ambalazh vendoset etiketa ku shënohen të dhënat e mëposhtme.

Ndërrmarrja prodhuese.

Lloji i miellit.

Data e prodhimit dhe data e skadimit.

**Ambalazhimi:** Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në menyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.

Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mirë ,të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.

Transporti të bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga faktorët atmosferikë duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

## Specifikime teknike per artikullin

### “BUKA”

Bazuar në STASH .....1411/87

Lloji: Buke gruri me miell rreze 75 %

#### Treguesit shqisor

**Korja: E lëmuar**, pa filluska, pa çarje e pjesë të djegura dhe pa shkëputje të saj nga tuli, me ngjyrë të njellojtë mjalti në të kuqerremtë.

**Tuli:** Masë e njellojtë e pjekur mirë, jo e ngjitshme me pofre të shpërndara në menyrë të njëtrajtshme dhe pa gjurmë mielli të pa brumosur. Kosinstenca elastike me shtypje të lehtë rikthehet në gjendjen e parë, jo i thërmueshme dhe pa shtresa.

**Era dhe shija : E këndshme** e bukës së pjekur mirë, pa erë e shije të hidhur, të thartë, myku ose të huaj. Nuk lejohet kërcitje.

**Forma :** E rregullt pa shtypje e deformime.

**Lëndët e huaja :** .....nuk lejohen.

#### Treguesit fiziko – kimik:

- ❖ Lagështira në % jo më shumë së .....45
- ❖ Poroziteti në % jo më pak se .....70
- ❖ Aciditeti në gradë jo më shumë se.....4.5

Buka dërgohet për konsum jo me parë se..... 3 ore nga koha e pjekjes

Masa e caktuar sipas llojit të bukes duhet t'i pergjigjet mases ...3-4 ore pas kohës së pjekjes

Ambalazhimi: Buka ambalazhohet në kuti plastike të lejuara për produktet ushqimore.

**Transporti i bukes** bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

## Specifikime teknike për artikullin

### “REÇEL”

#### CILËSIA E I-rë

Treguesit cilësorë të recelit:

**1.Pamja e jashtme:** Jo e shëndritshme, e pasheqerosur, me sipërfaqe të njellojtë, ku shënja myku dhe fermetimi nuk lejohen, pa pjesë të djegura, fletë fruit, fara dhe pjesë të fermetuara. **2.Ngjyra:** E njellojtë, karakteristike e frutave të përdorura të ziera me sheqer.

**3.Shija dhe era:** Me erë të pëlqyeshme, karakteristike e frutit që mbizotëron në përzierje, pa erë të huaj. Shija të jetë e pëlqyeshme, e ëmbël pa shije karamalizimi e fermetimi, pa shije të hidhur ose çfarëdo shije tjetër të huaj.

**6 Treguesit kimik:** 1..Lende reduktuese (sheqer invert) jo me shume se 0,1%. 2..Lageshtia jo me shume se 0,16%. 3..Hiri jo me shume se 0,07%.

#### Ambalazhimi:

-Të jetë i ambalazhuar hermetikisht në kavanoza qelqi , apo plastike me peshë 1-5 kg,me etiketë.

#### Marketimi:

Emërtimi i prodhuesit.

Emri i produktit .

Pesha neto ose vëllimi i produktit.

Data e prodhimit .

Data e skadimit.

Kushtet e vecanta të ruajtjes.

Malli të shoqërohet me certifikatë origjine dhe raportë analize të laboratorit.

## Specifikime teknike për artikullin

### ”SALCË DOMATE”

Bazuar në STAZH.....1429\87

#### Lloji: Salcë domate

**1.Pamja e jashtme:** Masë e njëllojtë me konsistencë paste, jo fibroze pa fara pa copa lekure pa pjese të karamelizuara të prishura ose të fermentura.

**2.Ngjyra:** E kuqe intensive karakteristike e salcës së domates e njëllojtë në të gjithë masën

**3.Era dhe shija:** Karakteristike e domates pa shije dhe erë të huaj pa shije karamelizimi prishje ose fermentimi .

#### Treguesit fiziko kimikë:

- Përmbajtja e ekstraktit të dobishëm sipas refraktometrit në % .....28 – 30
- Aciditeti i Përgjithshëm në raport me ekstraktin i shprehur ne acid acetic ne% jo me shumë se 0.1.
- Përmbajtja e sheqerit të përgjithshëm në % jo më shumë se..... 20.
- Kripa të klorurit të na të vetë lëndës së parë në % jo më shumë se 1.3..... 2
- Përmbajtja e acidit sorbik në mg\kg jo më shumë se .....600.
- Përmbajtja e metaleve të rënda në mg \kg jo me shumë se
  - Zink 20
  - Kallaj 250
  - Plumb 0.4
  - Baker 30
  - Arsenik 0.4

Ngarkesa mikrobike. Brenda kufijve të lejuar nga Ministria e Shëndetsisë.

Në salcën e domates nuk lejohen përmbajtje e lëndëve të huaja dhe përdoruesi i ngjuresve artificial.

#### Ambalazhimi, marketimi dhe etiketimi:

Ambalazhohet në kuti teneqeje të llakuara me masë..... 0.5 –1kg.

Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa e cila duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

- Emërtimi i prodhuesit
- Emërtimi i produktit masa bruto, neto.

- Përmbajtja e produktit e menyra e perdorimit
- Afati i garancisë (data e prodhimit dhe data e skadimit)

Salca ruhet në mjedise të thata, të pastra, të ajrosura, temperaturë deri në 28<sup>0</sup>C, lagështirë deri në 75 % i mbrojtur nga rrezet e diellit.

Transportimi bëhet nga mjete të mbuluara, të pastra, të destinuara për transport të artikujve ushqimorë.

**Ambalazhimi:** Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në menyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.

- Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta, të dukshme mire, të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.
- N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.
- Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.
- N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret një etikete shtese që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.
- Në rastin kur etiketa është zëvendësuar, apo plotësuar me një tjetër shënime të detyrueshme duhet të jenë pikë për pikë si të etiketës origjinale.
- Malli të shoqërohet me certifikatë orgjine dhe raportë analize të laboratorit.

### **Specifikime teknike për artikullin**

#### **“BISKOTA”**

**Biskota:** Të jenë cilësore, me shije të mirë, pa shenja myku ose prishje, të jenë sipas standardeve shtetërore, të ambalazhuara, me datë skadence mbi një vit nga data e furnizimit.

### **Specifikime teknike për artikullin**

#### **“ÇOKOLLATE”**

Artikulli çokollatë të jetë një produkt industrial, të ketë për bazë kakaon, cilësore, me shije të mirë, pa shenja myku ose prishje, sipas standardeve shtetërore, e ambalazhuar, me datë skadence mbi një vit nga data e furnizimit.

### **Specifikime teknike për artikullin**

#### **“ÇAJ MALI”**

**Lloji:** Çaj mali.

**Era dhe Shija:** Erë dhe shije normale karakteristike e çajit. **Cilësia:** Të jetë cilësia e parë, e pastër nga barishtet dhe papastërtitë, pa lagështirë, me ngrën karakteristike të tij të gjelbër të lehtë.

**Ambalazhimi:** Të jetë i ambalazhuar

## Specifikime teknike për Mish, Prodhime Mishi, Vezë.

Për produkte mishi e të përpunuara operatorët ekonomik duhet të operojnë duke plotësuar standardet në fuqi për sigurinë ushqimore, kushtet që duhet të plotësojnë ushqimet me origjinë shtazore të cilat përcaktohen dhe sipas Dokumentit të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kombëtar të Ushqimit i datës 19.11.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike për prokurimin e produkteve ushqimore” dhe shtojcës 1, bashkëlidhur këtij dokumenti.

### Specifikime teknike për artikullin

#### “MISH VIÇI I FRESKET”

**Bazuar në STASH ..... 1441\87**

**Lloji:** Mish viçi i freskët cilësia e parë

#### **Kerkesat cilesore :**

**Pamja e jashtme:** Sipërfaqja e mishit është e mbuluar me një cipë të hollë të thatë. Sipërfaqja e mishit pas prerjes është e lagur dhe e ndritshme, lëngu del me veshtiërsi dhe është i tejkuqshëm. Tendinat janë të shndritshme elastike dhe të forta.

**Ngjyra :** Mishi i viçit ka ngjyrë rozë e ndryshme nga lopa që ka ngjyrë të kuqe dhe kau me ngjyrë të kuqe të mbyllur. Në prerje sipërfaqja është e ndritshme, ngjyra e dhjavit është e bardhë tek kafshët e reja, ndërsa tek kafshët e rritura është e verdhë.

**Era :** E këndshme, karakteristike e llojit.

Ngjyra është rozë e verdhë.

Në prerje është e ndritshme.

**Lengu i mishit pas zierjes :** I tejdukshëm aromatik, në sipërfaqe duket shtresa ose pika yndyrë.

#### **Treguesit kimiko mikrobik :**

1. Azot i tretshëm, në mg, Amoniak (NH<sub>3</sub>) për 100 gr produkt jo me shumë se.....20.

2. Aciditeti i shprehur në pH ..... 5.2 deri në 6.4.

3. Reaksioni për hidrogjenin sulfuror negativ.

4. Ngarkesa mikrobike brenda normave të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Treguesit kimik e mikrobik analizohen vetëm në ato raste kur dyshohet për ndryshimet që ka pësuar mishi.

#### **Ambalazhimi dhe marketimi;**

Çdo parti/karkasë mishi shoqërohet me certifikatë veterinarë, e cila garanton sigurinë e produktit “mish” dhe më të cilën vërtetohet se nga kontrolli i kryer nuk është prekur nga sëmundje, por që është i sigurt dhe se lejohet të tregtohet për konsum publik.

Vula e raportit veterinar të jetë e lexueshme mirë dhe çdo pjesë e karkasës (shpatull, kofshë dhe gjoks) duhet të jetë e vulosur me vulën e kontrollit veterinar.

**Transporti i mishit** brenda rrethit bëhet me mjete të mbyllura të pastra e të dezinfektuara posaçërisht për mishin me aparat matës temperature (taograf).

Transportimi jashtë rrethit të bëhet me autofrigorifer.

## Specifikime teknike për artikullin

### “KONSERVA ME MISH VIÇI”

Bazuar në STAZH.....	1544-87zv me 1544-79,3211-83
ZV .....	4003 –85
Grupi .....	J-13
KDU .....	664.93

Ky standard përcakton kërkesat kryesore me mish viçi të përgatitura me lëngun e vet, të ambalazuara me kuti metalike (llamarine) të mbyllura hermetikisht dhe të sterilizuara.

Si lëndë e parë për prodhimin e konservave me mish viçi cilësia e parë.

Në të gjitha rastet mishi i freskët i therur të pajiset me çertifikatën e kontrollit veterinar.

Mishi për prodhimin e konservës përdoret në gjendje të freskët ( i ftohur) ose i çngjirë nga mishi i ruajtur në gjendje të ngjirë.

Më parë mishi seleksionohet nga të gjitha indet me vlerë të pakët.

#### Lëndët ndihmëse.

- ❖ Kripë gjelle e pastër
- ❖ Piper i zi kokërr
- ❖ Fletë dafine e dizifektuar dhe e tharë
- ❖ Kutitë llamarine

Nr	Emertimi	Treguesit
1	Shija dhe era	Karakteristikë e mishit të viçit
2	Pamja e jashtme e kutise	E mbyllur, pa fryrje dhe deformime mekanike, pa njolla oksidimi, pa dëmtime së shtresës së llakut ,lejohen njolla ngjyre
3	Sasia e mishit ndaj masës së konservës në % jo më pak se	72
4	Yndyrna në % jo me pak se	13
5	Kripë në %	1-2
6	Përmbajtja e kriprave të metaleve të rënda mg\kg jo më shumë se : Kallaj, bakri, zinku, plumbi, arseniku	200, 10, 70, 2, 1
7	Ngarkesa mikrobike	Brenda kufijve të lejuar nga Ministria e shëndetësisë.
8	Konsistenca e mishit	Normalisht të jete elastike dhe të ruaj strukturën morfologjike të indit. Ngjyra e lëngut kafe e celur ne krem.

#### Ambalazhimi, marketimi dhe etiketimi:

- Ambalazhohet në kuti teneqeje të kallaisura dhe të llakuara masa e kutise 100 - 500gr produkt.
- Mbi çdo kuti vendoset etiketa me mbishkrimin ;
- Emërtimi i prodhuesit.

- lloji i konservës(konservë me mish vici)
- Data e prodhimit, masa neto

**Në çdo kuti vendosen etiketa ku shënohen:**

- Emërtimi i prodhuesit
- Emërtimi i produktit masa bruto, neto.
- Përmbajtja e produktit e menyra e përdorimit
- Data e prodhimit,
- Afati i garancisë (Data e jetëgjatësisë minimale)

**Aambalazhimi:** Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet në menyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.

1. Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jenë të qarta ,të dukshme mire ,të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme në kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.
2. N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jetë lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.
3. Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.
4. N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret një etikete shtese që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.
5. Në rastin kur etiketa është zëvendësuar, apo plotësuar me një tjetër shenimet e detyrueshme duhet të jenë pikë për pikë si të etiketës origjinale.
6. Malli të shoqërohet me certifikatë orgjine dhe raportë analize të laboratorit.

**Specifikime teknike për artikullin**

**"KONSERVA SARDELE ME VAJ ULLIRI"**

Bazuar në STAZH.....1517\87

**Lloji: Konservë me vaj ulliri**

**Era dhe shija :** E këndshme ,specifike për sardelen e konservuar pa shije dhe erë të huaj.

Konsistenca e mishit: Të jetë kompakt, i thyeshëm jo i qullët kur nxirret me kujdes nga kutia nuk themohet.

**Madhësia:** Sardellet të jenë të plota, lejohen diferenca në gjatësi jo me shumë se..... 1.5 cm  
Gjatësia e sardeleve të jetë jo më pak se .....7 cm.

Qartësia e vajit dhe paraqitja e sardeleve në kuti: Vaji pas dekantimit të jetë i kthejllët.

Sardellet të jenë të plota të prera drejt pa njolla gjaku dhe zorre.

Copa bishti dhe koka peshku nuk lejohen.

**Pamja e jashtme e peshkut** të jetë e rregullt.

Lejohen plasaritje të lekures së peshkut deri në 20% të sipërfaqes së dukshme me hapjen e kutisë.

**Pamja e brendshme** e kutisë : Lejohen njolla blu-violete.

Raporti i masës në %..... sardele me vaj 80 me 20 ±5% .

Lende të huaja e pjese lundruese të bishtit .....nuk lejohen.

Përmbajtja e kripës së gjellës në raport me masën neto..... 1 – 2 %

Përmbajtja e kripave të metaleve ne mg\kg konserv jo më shumë se:

- Kallaj 250
- Plumbi 2
- Bakri 5

#### **Ambalazhimi, marketimi dhe etiketimi:**

- Ambalazhohet në kuti metalike të llakuara të mbyllura hermetikisht me mase 100 – 200 gr.

#### **Mbi ambalazh vendoset etiketa me të dhenat e meposhtme:**

- Ndërmarrja (firma) prodhuese
- Emërtimi i produktit masa bruto, neto.
- Përmbajtja e produktit e menyra e përdorimit
- Afati i garancisë data e prodhimit, data e skadimit (Data e jetëgjatësisë minimale)
- Kutitë e tubetat vendosen në arka kartoni .Mbi arkë vendoset:
- Emërtimi i prodhuesit
- Lloji i prodhimit
- Numri i kutive
- Datën e prodhimit, data e skadimit (Data e jetëgjatësisë minimale)

#### **Ruajtja e transportimi**

Sardele me vaj ulliri ruhet në mjedise të thata, të pastra, të ajrosura, temperaturtë deri ne 4 - 14 °C.

Transportimi bëhet nga mjete të mbuluara, të pastra ,të destinuara për transport të artikujve ushqimorë.

**Aambalazhimi:** Etiketa e produktit të ambalazhuar duhet të fiksohet ne menyrë që të mos shkëputet nga ambalazhi.

❖ Shënimet e detyrueshme të marketimit duhet të jene të qarta ,të dukshme mire ,të pashlyeshme dhe lehtësisht të lexueshme ne kushtet normale të blerjes dhe përdorimit.

❖ N.q.se është i mbuluar me një material veshës të gjitha informacionet e detyrueshme duhet të figurojnë mbi këtë të fundit ose etiketa e ambalazhit duhet të jete lehtësisht e lexueshme dhe jo e maskuar nga ambalazhi.

❖ Emri i produktit ushqimor dhe përmbajtja neto duhet të bjerë në sy që në pamje të parë.

❖ N.q.se gjuha në etiketën origjinale nuk është e pranueshme për konsumatorin për të cilin ajo është e destinuar duhet të përdoret nje etikete shtese që përmban informacionin e detyrueshëm në gjuhën shqipe.

❖ Në rastin kur etiketa është zëvendësuar , apo plotësuar me nje tjetër shenimet e detyrueshme duhet të jene pikë për pikë si të etiketës orgjinale.

Malli të shoqërohet me certifikatë orgjine dhe raportë analize të laboratorit.

### **Specifikime teknike për artikullin**

#### **“SALLAM (SALÇIÇE)”**

Me përberje mish lope, vici ose pule ,i paketuar në pako treshe celefone, nga 250 gr secila i freskët dhe i pajisur me çertifikatën sanitare, të mos përmbajë shumë yndyre dhe furnizimi të bëhet me mjete frigoriferike. Mishi te jete ngjyrë rozë dhe të ketë erë te këndshme.

Malli të jetë i shoqëruar me certifikate cilësie me të gjithë parametrat.



## Specifikime teknike për artikullin

### “VEZE PULE”

Bazuar në STASH..... 1515-85

#### Lloji.Vezë pule

#### Kërkesat Cilësore

**1. Pamja e jashtme.** E paster dhe pa plasje. Lejohen ndotje të lehta.

**2. Dhoma e ajrit** (lartesia ), mm, jo me shume se..... 9

**3. E bardha e vezes.** E dendur e kulluar dhe e paster pa njolla gjaku ( të kontrolluar ne ovoskop).

**4. E verdha e vezës .**Kompakte e ndodhur në pozicionin qendror pak e levizshme .Lejohet devijim i vogel nga pozicioni qendror.

**5-Era.** Pa erë prishje dhe erë tjeter të huaj.

**6-Masa.** Në gr, jo më pak se..... 40.

#### Ambalazhimi

1. Vezët ambalazhohen në kartona fole me kapacitet 30 vezë secila dhe në çdo kuti kartoni vendosen 12 copë kartona fole
2. Mbi çdo ambalazh vendoset etiketa ku shenohen .

Emri i ndermarrjes prodhuese,  
Sasia,  
Data e prodhimit.

## Specifikime teknike për artikullin

### “FILETO PULE”

- **Pamja e jashtme:** Me ngjyre rozë e çelur që anon në të bardhë karakteristika e mishit të pulës së freskët, pa shtresa të tepërta dhjami cilësi e parë.

- **Ndarja anatomike;** Mishi i pulës do të përbëhet vetem nga pjese të kraharorit të pulës; Fileto të jetë e shoqëruar me fletë analize përkatëse,

- **Paketimi:** Të jetë me kuti ku të jetë shënuar pesha dhe Data e prodhimit.data e skadences Emri i ndermarrjes prodhuese sasia.

- **Treguesit kimik ;** Në përputhje me Standartin Shtetëror Shqiptar

- **Era :** E këndshme, karakteristike e llojit.

- **Transporti i filetos** brenda rrethit behet me mjete të mbyllura të pastra e të dezinfektuara posaçërisht për fileton me aparat matës temperature (taograf).

- Transportimi jashtë rrethit të bëhet me autofrigorifer.

## Specifikime teknike për Zarzavate (Perime) dhe Fruta

Produktet ushqimore fruta e perime të papërpunuara shoqërohen me fletë analiza për çdo sasi malli të lëvruar.

Zarzavatet të jenë sipas stinës duke përfshirë të gjitha llojet si: Domate, qepë, specë, patëllxhana, karrota, presh, lakër, bizele, bamje, etj.

### Specifikime teknike për artikullin

#### “BIZELE”

Bazuar në STASH.....1713-88

**Lloji.** Bizele për treg cilësia e parë

#### Kerkesat cilësore të bizeles kokërr

- 1. Pamja e jashtme.**Të njoma, të freskëta, të pastra e të paçara, me ngjyre të kultivarit, me pjekuri teknike dhe madhesi normale të kultivarit.
2. Pa dëmtime mekanike , njolla ndryshku nga antraknoza, ndezje e kalbje.

#### Kërkesat cilësore të bizeles bishtajore

- 1. Pamja e jashtme** .Të freskëta, të njoma, të pastra, të pathyera, me ngjyrë e madhësi të kultivarit.
- 2. Kokrrat në bishtajë.**Me madhësi normale të kultivarit, të zhvilluara mire në fazën qumështore, me ngjyrë jeshile të hapur, me lëkure të hollë, të njomë e të embel, pa shenja drunjëzimi.

**3- Dëmtime mekanike,** njolla ndryshku, nga antraknoza, ndezje e kalbje.

Lejohen të vrara .....5%.

Nuk lejohen me njolla ndryshku nga antraknoza me ndezje e kalbje .

**Ambalazhimi dhe etiketimi** bazuar në standardin.....1799\88

Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarëve në arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standardit ose kushtit teknik perkatës në fuqi.

Çdo parti perimesh shoqërohet me etiketë ku shënohet

- Emërtimi i prodhuesit
- Lloji i prodhimit
- Cilësia
- Masa bruto dhe neto

Transporti i perimeve të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore

### Specifikime teknike për artikullin

#### “PRESH”

Bazuar në STASH ..... 1759-88

**Lloji.** Presh për treg cilësia e parë

### **KERKESAT CILESORE**

**Pamja e jashtme.** I freskët i pastër i njomë, me ngjyrë të bardhë në jeshile, i pavyskur dhe i larë me ujë të pijshëm .

- Diametri në pjesën me të trashë, cm. ....mbi 2.5-3.5
- Gjatësia e kërcellit në cm..... . 25-45
- Gjatësia e gjethit nga rozeta, cm,.....jo me shumë se 20
- Sistemi rrenjor, cm, .....jo me shumë se 1.
- Dëmtime e sëmundje .....nuk lejohen

**Ambalazhimi dhe etiketimi.** Bazuar në standardin.....1799\88

Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarëve në arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standardit ose kushtit teknik të perkatës në fuqi.

Perimet gjethore të standardizuara në tufa dhe lidhen si me poshtë .

Preshi lidhet në tufa në dy vende dhe këto vendosen në arka tip.

### **Çdo parti perimesh shoqerohet me etikete ku shenohet**

- Prodhuesi
- Lloji i prodhimit
- Cilësia
- Masa bruto dhe neto

**Transporti** i perimeve të freskëta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

## **Specifikime teknike për artikullin**

### **“DOMATE”**

Bazuar në STASH..... 1726-88

**Lloji.** Domate për treg cilësia e parë

### **KËRKESAT CILËSORE**

**Pamja e jashtme.** Të freskëta, me formë tipike të kultivarit, të plota, të pastra, të pavrara, të pashtypura, pakalbje dhe pa njolla nga djegia e diellit, të paprekura nga semundjet dhe dëmtuesit si dhe të palagura.

**Pjekuria dhe ngjyra .** Me pjekuri normale, me ngjyrë të kuqe,lehtësisht roze dhe jeshile rreth bishtit. Nuk lejohen domate të tejpekura, të zbutura e të vyshkura.

**Dëmtime e sëmundje**.....nuk lejohen.

**Të plasura e të vrara lehtësisht.** Për llojet e mesme dhe të vona lejohen deri ne 5% plasaritje rreth bishtit por pa rrjedhje lëngu (të kalçifikuara

Madhësia e kokrës (diametri më i madh gjerësor ),cm, jo me pak se

Për të hershmet .....	5
Per të mesmet dhe të vonat .....	7
Për të mesmet e të vonat kumbullore.....	(gjatesia 5)
<b>Ambalazhimi dhe etiketimi</b> bazuar në standardin .....	1799\88
Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarëve në arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standardit ose kushtit teknik të perkatës në fuqi.	

**Çdo parti perimesh shoqërohet me etiketë ku shënohet:**

- Prodhuesi
- Lloji i prodhimit
- Cilësia
- Masa bruto dhe neto

Transporti i perimeve të freskëta behet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno - sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

### Specifikime teknike për artikullin

#### “PATELLXHANE”

Bazuar në STASH..... 1730/88

#### Lloji. Patëllxhan për treg cilësia e parë

##### Kërkesat cilësore

**Pamja e jashtme.** Karakteristikë e kultivarit. Të freskëta, të pastra, me sipërfaqe të lemuar me ngjyrë të zezë manushaqe me pjekuri normale me fletë jeshile me nuanca të dobëta manushaqe, të pa vyshkura .

**Dëmtime të ndryshme e sëmundje**.....nuk lejohen  
të kalbura, të mykura, të ngrira..... .nuk lejohen

##### Madhesia ne cm.

- a) diametri jo me shume se
- ❖ Per të gjatat..... 5
  - ❖ Per të rrumbullaktat..... 12
- b) Gjatesia e bishtit në cm jo më shumë se..... 4

**Ambalazhimi dhe etiketimi** bazuar në standardin..... 1799\88

Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve ne arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standardit ose kushtit teknik të perkates ne fuqi.

**Çdo parti perimesh shoqërohet me etiketë ku shënohet:**

- Prodhuesi
- Lloji i prodhimit
- Cilesia
- Masa bruto dhe neto

Transporti i perimeve të freskëta behet me mjete të pastra të mbrojtura nga demtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

## Specifikime teknike për artikullin

### “TRANGULLI”(KASTRAVECI)

Bazuar në STASH..... 1754\88

**Lloji** :Trangull për treg cilësia e parë.

**Kërkesat cilësore :**

**Pamja e jashtme:** Të freskët me ngjyrë e formë tipike të kultivarit , me perkulje të lehtë .

**Përbërja e brendshme e tulit:** Me tul të fortë e të lëngshëm. Farat e pa zhvilluara e pa kore të fortë.

**Madhësitë:**

- Gjerësia në cm (diametrik më i madh ).....deri 5
- Gjatësia në cm.....nuk kërkohet

**Dëmtime mekanike** (gërvishtje të lehta në lekure) në%, të prekura nga insektet të kalbura..... nuk lejohen.

**Ambalazhimi dhe etiketimi** bazuar në standardin.....1799\88

Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarëve në arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standardit ose kushtit teknik perkatës në fuqi.

**Çdo parti perimesh shoqërohet me etiketë ku shënohet:**

- Prodhuesi
- Lloji i prodhimit
- Cilësia
- Masa bruto dhe neto

Transporti i perimeve të freskta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno - sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

## Specifikime teknike për artikullin

### “SPECA ”

Bazuar në STASH .....1756\88

**Lloji** : Spec për treg cilësia e parë

**Kërkesat cilësore :**

**Pamja e jashtme:** Me ngjyrë e formë tipike të kultivarit, të freskta, të pastra dhe me pjekuri teknike

**Dëmtime ne %** (të shtypura, të gërvishtura ) jo me shume se ..... 3

**Shija.** Karakteristikë e kultivarit. Lejohet shije djegëse e lehtë. Nuk lejohet përzierje e specave djegës me ato jo djegës.

**Gjatësia,cm**

- Për të gjatat.....mbi, 10
- Për të rrumbullaktat.....mbi, 7

**Ambalazhimi dhe etiketimi** bazuar në standardin.....1799\88

Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarëve në arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standardit ose kushtit teknik përkatës në fuqi.

### Çdo parti perimesh shoqërohet me etiketë ku shënohet

- Prodhuesi
- Lloji i prodhimit
- Cilesia
- Masa bruto dhe neto

Transporti i perimeve të freskëta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

### Specifikime teknike për artikullin

#### “LAKER”

Bazuar në STASH.....1758-88

### Lloji Lakër për treg cilësia e parë

#### Kërkesat cilësore

**Pamja e jashtme:** Të zhvilluara, me mbështjellje fletësh, e fortë në prekje.

Lejohen lakra të pangjeshura .....deri 5% të parties

**Pastrimi dhe gjatesia e koçanit.:**Të jenë të pastruara dhe me 2-3 gjethe të gjelbëra, të lidhura me koçanin i cili të jetë .....deri në 3cm.

**Dëmtime të ndryshme mekanike,** me sëmundje.....nuk lejohen.

Lejohen deri në 5% e partisë me dëmtime të lehta mekanike, të çara lehtësisht e të shperthyera si dhe të demtuara lehtësisht nga bryma.

#### Pesha e kokrrës :

- Per lakrën e hershme, jo me pak se..... 1 kg .
- Per lakren me pjekje të mesme e të vona , .....jo me pak se 1.5 kg.
- Per lakren tip “Drinishti” hibride etj ,.....jo me pak se 0.8 kg.

**Ambalazhimi dhe etiketimi** bazuar në standardin..... 1799\88

Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarëve në arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standardit ose kushtit teknik të perkates në fuqi.

### Çdo parti perimesh shoqërohet me etikete ku shënohet:

- Prodhuesi
- Lloji i prodhimit
- Cilesia
- Masa bruto dhe neto

Transporti i perimeve të freskëta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

## Specifikime teknike për artikullin

### “QEPE”

Bazuar në STASH ..... 1755\88

**Lloji: Qepë e njomë dhe e thatë cilësia e parë**

**Kërkesat cilësore :**

**Qepa e njome:**

**Pamja e jashtme:** të njoma, të freskta, të pastra , të lara me uje të pijshëm, me ngjyrë jeshile të gjetheve, të pa çara, të pavyshkura dhe pa karabush.

Lejohet një karabush në tufë i pakëputur dhe jo me i gjatë se .....5 cm.

**Diametri i kercellit në cm :** ..... mbi 1.5

**Gjatesia** e tufës në cm: pa kufizim në gjatësi dhe me bishta të paprerë.

**Sistemi rrenjor** në cm..... deri ne 1

**Demtime mekanike** ne % .....nuk lejohen

**Gjethe të verdha** e të lagura ,karabush të mëdhenj , të gjate e të kalbur..... .nuk lejohen

### QEPE E THATE

**Pamja e jashtme:** Me pjekuri të plote, me cipë e bisht të thatë, të shendosha e të plota. Me ngjyre e forme tipike të kultivarit dhe me gjatësi të bishtit..... deri ne 7 cm.

**Diametri ne cm (madhesia e kokrres )**

- për ovalet .....4-8
- për llojet e tjera.....5-10

**Dëmtime mekanike** (cifla, bishta, sëmundje),

- Me dëmtime të lehta lejohen jo më shumë se .....1 % e parties
- Lënde të huaja ( cifla, bishta) lejohen jo më shumë se.....1 %).
- Me sëmundje .....nuk lejohen.

**Të ngrira,** Të kalbura e të mykura..... nuk lejohen.

Lejohet furnizimi me qepë të thata të thurura në vargje me gjatësi të ndryshme. Pesha e materialit që përdoret për thurje në vargje të mos kalojë 6 % të masës së përgjithshme.

**Ambalazhimi dhe etiketimi** bazuar në standardin..... 1799\88

Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarëve në arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standardit ose kushtit teknik të përkatës në fuqi.

Patatja dhe qepa e thatë ambalazhohen edhe në thasë.

Perimet gjethore të standardizuara në tufa dhe lidhen si më poshtë.

Qepa e njomë dhe preshi lidhet në tufa në dy vend dhe këto vendosen në arka tip.

**Çdo parti perimesh shoqërohet me etiketë ku shënohet:**

- Prodhuesi
- Lloji i prodhimit
- Cilesia
- Masa bruto dhe neto

Transporti i perimeve të freskëta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik duke zbatuar rregullat higjieno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

### **Specifikime teknike për artikullin**

#### **“HUDHRA”**

##### **Pamja e jashtme:**

Me pjekuri të plotë.

Me cipë e bisht të thatë, të shendosha e të plota. Me ngjyrë e forme tipike të kultivarit dhe me gjatësi të bishtit deri në 4 cm.

Të lidhura në varg ose me rrjeta deri në 250 gr.

Dëmtime mekanike cifla, bishta, sëmundje, lejohen jo me shume se 1 % e partisë me dëmtime të lehta dhe 1 % lende të huaja ( cifla, bishta). Me sëmundje nuk lejohen.

Të ngrira ,të kalbura e të mykura nuk lejohen.

##### **Ambalazhimi dhe etiketimi**

bazuar ne standartin 1799\88

Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve ne arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik të perkates ne fuqi.

### **Specifikime teknike për artikullin**

#### **“KARROTA”**

Lloji :Karrota për treg cilësia e parë.

Kërkesat cilësore :

##### **Pamja e jashtme:**

Të freskët me ngjyrë e forme tipike të kultivarit , me perkulje të lehtë .

Ambalazhimi dhe etiketimi

Bazuar në standardin 1799\88.

Perimet ambalazhohen të ndara sipas kultivarve ne arka të pastra të forta e të thata të prodhuara sipas standartit ose kushtit teknik perkatës në fuqi.

Çdo parti perimesh shoqërohet me etiketë ku shenohet:

Prodhuesi .

Lloji i prodhimit.

Cilësia .

Masa bruto dhe neto.

Transporti i perimeve të freskëta bëhet me mjete të pastra të mbrojtura nga dëmtimet e faktorët e tjerë atmosferik, duke zbatuar rregullat higjieno - sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

### **Specifikime teknike për artikullin**



## “PATATE”

Bazuar në STASH ..... 1729/88

**Lloji:** Patate verore e dimërore

**Kërkesat cilësore :**

**Pamja e jashtme:** Të plota, të forta, të pastra e të thata, jo jeshile, jo të mbira me ngjyrë dhe me sytha tipik të kultivarit.

**Pjekuria: Kokrra të pjekura.**

**Madhësia e kokrrës** (diametrik më i madh ) në cm mbi

- ❖ për të rumbullaktat dimerore, .....5; .....verore, 4
- ❖ për vezaket dimërore dhe verore..... 4
- ❖ për të zgjaturat .....3.5

**Lejohen:** lehtësisht të gjelbra në % jo më shumë se

- .....3 për dimëroret ; .....1 për veroret
  - b) të mbira ne % jo me shumë se 1 per dimëroret dhe .nuk lejohen për veroret
